



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 1 , Datë 16/01/2014

**“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR
SHPENZIMET E LEJUESHME MBI FONDET DHE PASURITË E TJERA TË
SEKUESTRUARA TË PERSONAVE TË SHPALLUR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të neneve 23, pika 3 dhe 29 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat dhe procedurat për shpenzimet e lejueshme mbi fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara të personave të shpallur sipas ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, në funksion të zbatimit të këtij ligji.

**Neni 2
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 3 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
“**Shpenzime të lejuara**” janë ato shpenzime që autorizohen për t’u përdorur nga personat e shpallur si shpenzime themelore apo shpenzime të jashtëzakonshme.
“**Shpenzime themelore**” janë shpenzimet bazë, duke përfshirë pagesat për ushqim, qira ose hipotekim, barna dhe trajtim mjekësor, taksat, premiot/primet e siguracioneve, tarifa dhe shërbime publike, ose ekskluzivisht për pagesa të tarifave

dhe rimbursimeve profesionale të arsyeshme dhe të shpenzimeve të kryera lidhur me shërbime/detyrime ligjore, tarifa për pagesa të shërbimeve për mirëmbajtje rutinë/të zakonshme ose mirëmbajtje të fondeve dhe pasurive të tjera të sekuestruara.

“**Shpenzimet e jashtëzakonshme**” janë ato shpenzime që nuk janë të përfshira në shpenzimet themelore dhe mund të lindin prej ngjarjeve, të cilat nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, ku përfshihen pa u kufizuar në fatkeqësitë natyrore, përmbytje, aksidente.

Neni 3

Autoriteti vendimmarrës

Ministri i Financave, bazuar në kërkesën e çdo personi, fondet dhe pasuritë e tjera të të cilit janë subjekt i një urdhër sekuestrimi sipas nenit 22 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, dhe marrjes së vlerësimit nga strukturat përkatëse, mund të lejojë pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara për t’i përdorur për shpenzime themelore apo shpenzime të jashtëzakonshme.

Neni 4

Kriteret dhe afatet e shqyrtimit të kërkesës

1. Kërkesa që i drejtohet Ministrit të Financave duhet të jetë e arsyetuar, të ketë të dhëna të plota për identifikimin e kërkuarit, punësimin dhe të ardhurat e tij, vendimin përkatës për përfshirjen në listë, llojin dhe sasinë e fondeve dhe pasurive të sekuestruara, pasqyrim të qartë të pretendimeve për shpenzime të vërtetuar me dokumentacion justifikues, sasinë e fondeve për të cilën kërkohet autorizimi dhe përdorimin që do i bëhet këtyre fondeve.
2. Në afatet për shqyrtimin e kërkesës, sipas nenit 23 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, nuk përfshihen ditët e pushimit apo festave zyrtare dhe nuk përllogariten as ditët e shtyrjes së autorizimit që mund të vijnë për shkak të komunikimit, marrjes së lejes apo autorizimit nga organet përkatëse në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo në organe të tjera ndaj të cilave vendi ynë ka detyrime.

Neni 5

Procedura e shqyrtimit të kërkesës për fonde dhe pasuri të sekuestruara sipas vendimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

1. Ministri i Financave, pas vlerësimit të kërkesës së personave të shpallur sipas nenit 14 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, sipas vendimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendos nëse kërkesa është e bazuar dhe autorizon përdorimin e fondeve dhe

pasurive të tjera për shpenzime themelore apo shpenzime të jashtëzakonshme.

Për vlerësimin e kërkesës, Ministri i Financave mund të thërrasë Komitetin e Posaçëm Këshillimor, të ngritur në bazë të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”.

2. Për kërkesat e lidhura me shpenzime themelore, Ministri i Financave, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, njofton Komitetin e Sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të marrë autorizimin për lejimin e këtyre shpenzimeve.

Ministri i Financave, me marrjen e miratimit ose në mungesë të një vendimi negativ nga Komiteti i Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga data e marrjes dijeni, mund të autorizojë pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara për t’i përdorur për shpenzime themelore.

3. Për kërkesat e lidhura me shpenzime të jashtëzakonshme, Ministri i Financave, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, njofton Komitetin përkatës të Sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të marrë autorizimin e tij.

Ministri i Financave mund të miratojë pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara për t’i përdorur për shpenzime të jashtëzakonshme, vetëm pasi të ketë marrë autorizimin nga Komiteti i Sanksioneve i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

4. Njoftimi për Komitetin përkatës të Sanksioneve për shpenzimet themelore apo të jashtëzakonshme duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme:
 - a) identifikimin e kërkuarit (emër, mbiemër, adresë, numër reference nga lista e konsoliduar e personave të shpallur)
 - b) të dhëna për llogarinë bankare të kërkuarit (emrin dhe adresën e bankës, numrin e llogarisë);
 - c) qëllimi i pagesës dhe arsyetimin e përcaktimit të shpenzimeve;
 - d) shumën e kërkuar dhe kështu përkatëse nëse i tillë është menduar të bëhet pagesa;
 - e) fondet dhe pasuritë e tjera ende në sekuestrim;
 - f) datën kur parashikohet kryerja e pagesave;
 - g) mënyrën e pagesës (në bankë apo me metode tjetër);
 - h) të dhëna të tjera që çmohen me interes.

Neni 6

Procedura e shqyrtimit të kërkesës për fonde dhe pasuri të sekuestruara sipas procedurës së brendshme të shpalljes

1. Ministri i Financave pas vlerësimit të kërkesës së personave të shpallur sipas nenit 15 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 “*Për masat kundër financimit të terrorizmit*”, mund të lejojë pagesa nga fondet dhe pasuritë e tjera të sekuestruara për t’i përdorur për shpenzime themelore apo shpenzime të jashtëzakonshme.

2. Për vlerësimin e kërkesës, Ministri i Financave mund të thërrasë Komitetin e Posaçëm

Këshillimor të ngritur bazuar në pikën 2, të nenit 15 të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013
“Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Neni 7
Autoriteti zbatues

Autorizimi i Ministrit të Financave për lejimin e shpenzimeve i përcillet për ekzekutim
Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHKËLQIM CANI

MINISTËR